

albanska

Pyetjet dhe përgjigjet mbi  
lagien në shtrat

*Broshura është botuar nga Akademia Suedeze Enures*

## Sa e zakonshme është lagia në shtrat?

Shumica e fëmijëve bëhen të terur në moshën 2-3 vjeçare, zakonisht më herët ditën se sa natën. Nëse një fëmijë edhe pas moshës 5-vjeçare shurrin në gjumë, atëherë bëhet fjalë për lagie në shtrat ose enures. Përafërsisht, çdo i pesti 5-vjeçar dhe çdo i dhjeti 7-vjeçar laget në shtrat. Numri i djemve është dyfish më i madh se i vajzave të cilët kanë këtë problem. Në moshën e adoleshencës ekziston dukuria e lagies në shtrat te 1-2%.



## Cili është shkaku i lagies në shtrat?


Akoma nuk dihet me siguri pse një pjesë e fëmijëve dhe të moshuarve nuk zgjohen kur ata kanë nevojë të shurrojnë. Hulumtimet bëjnë përparime dhe gjatë viteve të fundit dituria jonë mbi këtë është rritur dukshëm. Dihet se janë të përzier mekanizmat e trashëguar.

Tek 75% të fëmijëve të cilët lagen në shtrat rrjedhin nga një farefis ku ka nga ata që lagen në shtrat.

Lagia në shtrat nuk është gati asnjëherë e kushtëzuar nga shkaqet psikike. Fëmijët të cilët lagen në shtrat janë si edhe fëmijët tjerë, por, probleme mund të shfaqen nga lagia në shtrat. Fëmijët janë të shqetësuar për t'u treguar shokëve, p.sh. ata nuk guxojnë të bujnë te dikush, nuk gëzohen të shkojnë në kamp, etj. Kjo mund të shkaktojë një keqësim të vetëbesimit.

Është e zakonshme që prindërit të mendojnë, se fëmijët e tyre, të cilët lagen në shtrat, flenë më thellë në krahasim me fëmijët tjerë. Hulumtimi ka dëshmuar, se ata e kanë më të vështirë të zgjohen, përndryshe gjumi i tyre është normal. Është dëshmuar po ashtu se ata zakonisht kanë fshikëz të madhësisë normale dhe zbraze normale të fshikëzës.

Ndërkaq, një pjesë e fëmijëve të cilët lagen në shtrat, prodhojnë më shumë urinë natën se sa fëmijët e tjerë, të moshës së njëjtë, dhe ndonjëherë më shumë urinë se sa prodhojnë gjatë gjithë ditës. Zakonisht, kanalet e tyre të urinës janë të shëndosha, por ka gjendje, p.sh. infektim të kanaleve të urinës dhe çrregullim të fshikëzës, që mund të shkaktojë lagie në shtrat. Atëherë fëmija ka shpesh probleme nga ndonjë krizë edhe gjatë ditës.



## Çfarë kontrollimesh bën mjeku?

Fëmijët të cilët lagen në shtrat është mirë të takojnë një mjek para fillimit të trajtimit. Mjekët njoftohen me të dhënat mbi zhvillimin e fëmijës, si dhe mbi sëmundjet eventuale, nëse fëmija është kaps, nëse ka ndonjë problem me urinim ditën ose faktor të tjerë që mund të shpjegojnë enuresen. Pas kësaj bëhet një kontrollim i zakonshëm trupor dhe merret një provë urine.

## Çka mund të bësh vet?

Para moshës pesë vjeçare ndodhë që lagia në shtrat nuk trajtohet, sepse shumë prej tyre bëhen në mënyrë spontane të terur në këtë kohë. Është me rëndësi të bindësh fëmijën se nuk është faji i fëmijës, pse fëmija shurron në rrobat. Për t' i zvogëluar problemet e familjes, mund të blesh një dyshek jo të ndjeshëm, i cili është i lehtë për tu pastruar. Mund të marrësh, po ashtu, recetë për mbrojtës çarçafësh me aftësi të madhe thithje.

Të ngritësh fëmijën ndonjëherë natën, p.sh. kur të shkosh vet për të fjetur, mundet eventualisht ta mbajë fëmijën të terur.

Të ndalosh fëmijën të pijë, nuk e kuron fëmijën nga lagia në shtrat, por është gjë e mençur të mbash sasinë e lëngjeve ulët në mbrëmje, sidomos para se të bie fëmija të fle. Të ushqyerit me rregull, urinimi dhe kryerja e nevojës ditën me rregull, ia lehtëson fëmijës të jetë i terur natën.



## Çfarë metodash trajtimi ekzistojnë?

Ekzistojnë kryesisht dy metoda trajtimi të lagies në shtrat – alarmi dhe ilaçet.

### Trajtimi me alarm

Enuresalarmi është një lloj trajtimi që mund të shëroj lagien në shtrat. Ndërkaq, kërkohet si angazhim ashtu edhe qëndrueshmëri, si nga fëmija, familja ashtu edhe nga mjeku/infermierja/uroterapeuti trajtues.

Metoda besohet se e ndihmon trurin që ai edhe në gjumë t'i kuptojë sinjalet e fshikëzës, ashtu që ose zgjohet fëmija dhe shkon për të urinuar ose e mban urinën deri në mëngjes.

Alarmi aktivizohet nga pika e parë e urinës. Atëherë është qëllimi që fëmija të ndërpres urinimin, të zgjohet/të zgjosh fëmijën, të shkoj në banjë, për të kryer urinimin.

Në fillim të trajtimit mund të jetë vështirë për fëmijën për t'u zgjuar dhe aparati në vend të fëmijës zgjon pjesën tjetër të familjes, por, kur gjithçka funksionon, bëhet më e zakonshme me net të terura. Alarmin e mban fëmija derisa fëmija i ka pasur dy javë rresht të terura. Në rast ripërsëritje bëhet trajtimi edhe një periudhë.



## Ilaçet

Ndërkohë, janë provuar shumë lloje trajtimi me ilaçe. Sot ekzistojnë ilaçe me recetë të cilat janë efikase dhe me pak pasoja anësore.

Një nga ato është shumë e ngjashme me hormonet e trupit vasopressin që ka një efekt frenues të prodhimit të urinës natën. Ilaçet dhe alarmi mund të kombinohen nëse nuk arrihet efekti i mjaftueshëm vetëm me njërën alternativë.



## Përmbledhje

Shumë fëmijë vuajnë nga lagia në shtrat. Shpesh ekzistojnë probleme urinimi në faqet. Lagia në shtrat natën mund të trajtohet dhe duhet të trajtohet. Ekziston ndihmë për të gjithë.

Trajtimet më të zakonshme janë alarmi dhe ilaçet. Moshë e përshtatshme për t'ia filluar është mosha 6-vjeçare, por, nëse fëmijës i shkakton shumë probleme, trajtimi mund të fillojë që në moshën 5-vjeçare. Fëmija dhe familja zgjedhin së bashku me mjekun trajtimin më të përshtatshëm, në secilin rast individual. Nëse ky nuk është i suksesshëm, atëherë ndërrohet në metodën tjetër ose kombinohen të dy metodat.

Nëse fëmija nuk ndjen efektin e alarmit ose të ilaçeve, nuk duhet të dorëzohet.

- Afërsisht 10% të atyre që lagen në shtrat, në mënyrë spontane çdo vit bëhen të terur.
  - Një periudhë e re e trajtimit më vonë, mund të ketë efekt të mirë.
  - Gjatë kohës mund të merrni mjete ndihmëse si mbrojtës dysheku falas nga njësia pranuese ose nga infermierja e rajonit.
  - Në njësitë speciale të pranimit ofrohen edhe trajtime të tjera.
- Pyet mjekun tuaj për informacione të tjera.

Është me rëndësi që të mos gjykosh ose dënosh kurrë një fëmijë i cili laget në shtrat. Në vend të kësaj fëmija duhet lavdëruar për pjesëmarrjen e vet në trajtim. Duk u munduar dhe forcuar vetëbesimin tek fëmija, ia lehtëson fëmijës të bëhet i terur.

Vizito edhe : [www.tornnatt.nu](http://www.tornnatt.nu)



# SEA

*Pyetjet dhe përgjigjet mbi lagien në shtrat përfshihen në serinë e shkrimeve të Akademisë Suedeze Enures (SEAs). Kjo është shkruar në 1995 nga pediatri Søren Wille, Helsingborg dhe Håkan Westerlund, Malmö dhe riaktualizuar 2008 nga pediatri Annika Lindgren, Malmö.*

*Akademia Suedeze Enures është themeluar në 1993 si një grup ekspertësh dhe referuesish mbi çështjet ensures dhe të problemit të inkontinencës tek fëmijët dhe të rinjtë. Anëtarët përfaqësojnë pediatriinë e përgjithshme, mjekësinë shkollore, habilitimin neurologjik të fëmijëve, nefrologjinë e fëmijëve, urologjinë e fëmijëve, psikiatriinë e fëmijëve, urologjinë për të rritur, fiziologjinë e veshkave dhe neurofiziologjinë dhe uroterapinë.*